



Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK)

Nr. 24-BD/2025

Prishtinë: 13.05.2025

Bordi Drejtues i ODËS SË INXHINIERËVE NË FUSHËN E NDËRTIMIT, me numër fiskal 603383324, në mbështetje të: nenit 17, paragrafi 5, nënparagrafi 5.13 të LIGJIT NR. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit; nenit 24, paragrafi 1, nënparagrafi 1.20 të STATUTIT TË ODËS SË INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PERIUdhËN E PËRKOHSHME, të miratuar më datë 31.12.2024, me numër protokollit 8648/24; dhe në mbështetje të vendimit Nr. 19-BD/2025, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 13.05.2025, nxjerr këtë:

VENDIM

1. **Formimi i Komisionit për pranimin e mallit**, i cili do të përbëhet nga këta anëtarë:

I. Driton Kaloshi – Kryesues

II. Sami Kolgeci – Anëtar

III. Mimoza Shahini – Anëtare

2. Autorizohet stafi administrativ i OIRK-së që të procedojë me nënshkrimin e kontratës dhe realizimin e blerjes.
3. Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit Mbikëqyrës.
- Anëtarëve Themelues të Odës.
- Arkivit të OIRK-së.

Bordi Drejtues i OIRK-së:

1. **Arsim Rapuca**, Kryetar i OIRK-së _____
2. **Mimoza Shahini**, Anëtare e Bordit Drejtues të OIRK-së _____
3. **Kadri Morina**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____
4. **Afrim Demiri**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____
5. **Nebi Pllana**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____
6. **Bujar Jupaj**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____
7. **Sami Kolgeci**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____

ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
KOMISIONI PËR PRANIMIN E MALLIT

RAPORT I PRANIMIT TË MALLIT

Nr. 01 / Dt. 13.05.2025

Prishtinë

Bazuar në Vendimin Nr. 24-BD/2025, datë 13.05.2025, të Bordit Drejtues të OIRK-së, Komisioni i përbërë nga:

1. **Driton Kaloshi** – Kryesues
2. **Sami Kolgeci** – Anëtar
3. **Mimoza Shahini** – Anëtare

ka realizuar pranimin e mallit të furnizuar nga kompania **NEXT Plus**, në përputhje me **ofertën më të mirë për karakteristika të njëjta**, si dhe në përputhje me Vendimin Nr. 19-BD/2025 dhe raportin e vlerësimit të ofertave.

Të dhënat mbi mallin:

- **Lloji i pajisjeve:** Kompjuterë të tipit All-in-One
- **Sasia:** 5 (pesë) njësi
- **Çmimi total:** 2,750.00 € (me TVSH)
- **Afati i dorëzimit:** Brenda 5 ditëve pune
- **Garancia:** 12 muaj

Vlerësimi i Komisionit:

Pas inspektimit fizik dhe teknik të mallit të pranuar, Komisioni konstaton se:


- Pajisjet janë dorëzuar brenda afatit të përcaktuar;
- Specifikimet teknike janë në përputhje me kërkesat e OIRK-së;
- Karakteristikat e pajisjeve përputhen me ofertën e përzgjedhur si më e favorshme për karakteristika të njëjta;
- Pajisjet janë funksionale, të reja dhe të papërdorura;
- Është ofruar garancia e kërkuar për secilën njësi.

Përfundim:

Komisioni konstaton se malli është pranuar në gjendje të rregullt dhe në përputhje të plotë me kushtet e ofertës dhe kontratës. Rekomandohet arkivimi i raportit dhe procedimi me regjistrimin dhe përdorimin e pajisjeve nga administrata e OIRK-së.

Prishtinë, Dt. 13.05.2025

Anëtarët e Komisionit për Pranimin e Mallit:

Driton Kaloshi, Kryesues 

Sami Kolgeci, Anëtar 

Mimoza Shahini, Anëtare 